



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 453/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarë: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër komisionerëve të vendvotimit 1112b/02R, të fshatit Kqiq, Komuna e Mitrovicës për shkak të ndalimit të votimit, të qytetarit Musli Berisha në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë.

### Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.11.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik PDK dega në Mitrovicë, në të cilën theksohet se me datën 03 nëntor 2013, në qendren e votimit 1112B/02R në fshatin Kqiq të madh të komunes së Mitrovicës, rreth orës 16:00 Musli Berisha i lindur me 02.02.1942 në fshatin Kqiq të Madh me nr. leternjoftimi 1007269257 duke dashur të shfrytëzojë të drejtën e tij për të votuar, atij nuk i lejohet të votojë nga komisionerët e vendvotimit nr. 1112B/02R sepse në regjistrin e qytetarëve me të drejtë vote, në rubriken e të dhënave personale të personit në fjale në vend të nënshkrimit të tij qendron nënshkrimi i një personi tjetër.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së, parashihet se: *”Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it sikurse PZAPI-i mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

Pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik PDK-se, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë, lidhur me ndalimin e votimit të qytetarit në fjale, janë të pabazuara, nga shkak që nga parashtruesi e ankesës nuk është bashkangjitur asnjë provë shtese apo deshmi bindese ankesës së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikoheshin vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se ka ndodhur ndalim i votimit nga komisioneret e votimit, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) terregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 453/2013 më datën 07.11.2013



**Këshillë Juridik:**

*Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i*